



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 qershor 2024
Nr. Ref.:RK 2439/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI171/23

Parashtrues

Latif Zariqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 235/2020 të 3 korrikut 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Latif Zariqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili me autorizim përfaqësohet nga z. Taulant Ferizi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 235/2023] të 3 korrikut 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AC. nr. 2813/2021] të 4 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 3532/2014] të 20 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me dispozitat e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) i janë shkelur, por vetëm konteston nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përmes përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit Xhevat Bici.
6. Më 1 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI171/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Vendimit [Nr. KSH. KI171/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 7 shtator 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, në Gjykatë të dorëzojë kopjen e plotë të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 235/2023] të 3 korrikut 2023. Të njëjtën ditë, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës, Gjykatës Supreme.
8. Më 6 tetor 2023, Gjykata e përsëriti kërkesën për parashtruesin e kërkesës duke i dhënë afat shtesë prej 7 (shtatë) ditësh që në Gjykatë të dorëzojë kopjen e kërkuar të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
9. Më 27 tetor 2023, Gjykata pranoi kopjen e plotë të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, të dorëzuar përmes përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit Xhevat Bici.
10. Më 15 nëntor 2023, z. Taulant Ferizi, në emër dhe si përfaqësues i ri i parashtruesit të kërkesës para Gjykatës dorëzoi plotësimin e kërkesës KI171/23.

11. Më 15 nëntor 2023, Gjykata kërkoi nga z. Taulant Ferizi, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh të dorëzojë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 nëntor 2023, Gjykata pranoi autorizimin e kërkuar nga avokati z. Taulant Ferizi, tashmë si përfaqësues i ri i parashtruesit të kërkesës para Gjykatës.
13. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
14. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Bazuar në vendimet e gjykatave të rregullta, të dorëzuara përmes kërkesës së parashtruesit të kërkesës, rezulton që, më 8 shtator 2004, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit mbi Trashëgiminë [T. nr. 453/03] të 8 shtatorit 2004, parashtruesin e kërkesës e kishte shpallur trashëgimtar të babait tij të ndjerë H. Z. për dy (2) ngastra kadastrale, përkatësisht (i) ngastrën nr. 625-0 dhe (ii) ngastrën nr. 4217-0, në Zonën Kadastrale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: paluajtshmëritë e kontestuara).
16. Më 28 janar 2005, R. Z. dhe H. Z. paraqitën kërkesëpadi në Gjykatën Komunale kundër parashtruesit të kërkesës, përmes të cilës kërkuan që atyre t'ju njihet e drejta e pronësisë si bashkëpronarë të vetëm me nga ½ pjesë ideale të paluajtshmërive të lartcekura. Në kërkesëpadinë e tyre, R. Z. dhe H. Z. specifikuan se: (i) paluajtshmëria e kontestuar kishte qenë e evidentuar në emër të paraardhësve të tyre dhe të paditësit të parë R. Z.; dhe (ii) Aktvendimi mbi Trashëgiminë [T. nr. 453/03] i 8 shtatorit 2004, i Gjykatës Komunale, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës ishte shpallur trashëgimtar i paluajtshmërive të kontestuara është nxjerrë pa bazë ligjore.
17. Më 17 shtator 2010, Gjykata Komunale, në kuadër të procedurës kontestimore përmes Aktgjykimit [C. nr. 92/05] aprovoi kërkesëpadinë e R. Z. dhe H. Z., si të bazuar dhe aprovoi të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë e lartcekura.
18. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut).
19. Më 12 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 2037/2012]: (i) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar; (ii) prishi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale; dhe (iii) çështjen e ktheu në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore me arsyetim "*që të kërkohet sqarim plotësues nga eksperti i gjeodezisë sepse ndërrimet kadastrale nuk bëhen pa kurrfarë baze juridike*".
20. Më 20 nëntor 2019, Gjykata Themelore, në procedurë të rivendosjes, përmes Aktgjykimit [C. nr. 3532/14]: (i) aprovoi sërish kërkesëpadinë e R. Z. dhe H. Z., si dhe vërtetoi se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, në posedim me mirëbesim, si bashkëpronarë me nga ½ e pjesëve ideale të paluajtshmërive të lartcekura; (ii) detyroi parashtruesin e kërkesës që t'ua pranojë të drejtën e pronësisë R. Z. dhe H. Z. në paluajtshmëritë e lartcekura; dhe që (iii) ky aktgjykim t'iu shërbejë R. Z. dhe H. Z. për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në regjistrat e paluajtshmërive në Drejtorinë për Pronë dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës.

21. Gjykata Themelore, ndër të tjera, gjeti se në bazë të ekspertizës gjeodezike të vitit 2009, mendimit plotësues të dhënë në seanca, dy paluajtshmëritë, përkatësisht ngastrat kadastrale nr. 625-0 dhe nr. 4217-0 janë evidentuar në emër të paditësit të parë R. H. dhe janë të pandryshuara sot e kësaj dite.
22. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit paraqiti ankesë (i) për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 4 prill 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2813/2021] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
24. Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje siç pretendon parashtruesi i kërkesës, duke sqaruar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike, bazuar në të cilën rezultoi që: “[...]bazuar në dokumentacionin origjinal kadastral ku hyjnë edhe historiat nr. 952-3/2005-29 i datës 13.1.2002 i lëshuar nga shërbimi për kadastër në Krushevc të Serbisë bashkë me provat shtesë, i siguruar përmes rrugës zyrtare në procedurën penale PP.nr. 1958-3/2005, e që, nga ana tjetër nuk ekziston kurrfarë dëshmie për bazën juridike sipas të cilës prona lëndore është evidentuar në emër të tani të ndjerit H.Z], të cilin sipas Aktvendimit T.nr.453/03 i datës 08.09.2004, i ish Gjykatës Komonale në Prishtinë, e ka trashëguar djali i tij i padituri këtu”.
25. Më 23 maj 2023, parashtruesi i kërkesës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Përmes revizionit të tij, parashtruesi i kërkesës arsyetoi se: (i) Gjykata e Apelit nuk ka dhënë arsyetim ndaj ankesës së tij; dhe (ii) e njëjta gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar në bazë të parashkrimit fitues, për shkak se sipas tij nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, Gazeta Zyrtare 6/1980 e ish-RSFJ-së (në tekstin e mëtejme: LMTHJP).
26. Më 3 korrik 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 235/2023] revizionin e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
27. Gjykata Supreme theksoi se i “*pranon në tërësi, si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe atë të dytë, ngase në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë janë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe e drejta materiale, prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për zbatim të gabuar të së drejtës materiale [...]*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

A. Pretendimet e ngritura në kërkesën e dorëzuar më 21 gusht 2023

28. Gjykata fillimisht rikujton se në kërkesën e dorëzuar më 21 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës përfaqësohej nga avokati Xhevat Bici, sipas autorizimit të nënshkruar nga ai më 17 gusht 2023.
29. Në këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin [Rev. nr. 235/2020] të 3 korrikut 2023, duke mos saktësuar se cilat të drejta dhe liri të tija, të garantuara me dispozitat e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës së Republikës

së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) i janë shkelur përmes aktvendimit të kontestuar, por vetëm kontestoni nën 53 [Interpretimi i Dispozitivave për të drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “[...] *pronësia që kanë fituar paditësit në bazë të parashkrimit fitues në këtë rast nuk ekziston sepse i padituri, respektivisht babai i të paditurit këtë pasuri e ka në posedim dhe shfrytëzim dhe në anë të tij, prandaj nuk janë plotësuar kushtet nga neni 28, paragrafi 4 i LTHMPJ-së dhe i mungon mirëbesimi*”.
31. Për më tepër parashtruesi i kërkesës thekson se “*deri te shkelja e ligjit ka ardhur për shkak të mungesës së dokumentacionit kadastral, respektivisht regjistrin ABC-së nga i cili shihet me rastin e shqyrtimit publik [...]*”.

B. Pretendimet e ngritura në “plotësimin e kërkesës” të dorëzuar më 15 nëntor 2023

32. Gjykata rikujton se më 15 nëntor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të ri, avokatit, Taulant Ferizi, dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës së tij. Përmes plotësimit të kërkesës i njëjti kontestoi Aktgjykimin [Rev. nr. 235/2023] të 3 korrikut 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AC. nr. 2813/2021] të 4 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 3532/2014] të 20 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore.
33. Në kërkesën për plotësim të kërkesës KI171/23, të dorëzuar nga përfaqësuesi i ri ligjor, ky i fundit pretendon se aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Më konkretisht, përmes plotësimit të kërkesës, të dorëzuar përmes përfaqësuesit të ri ligjor pretendohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutë në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 KEDNJ-së dhe të njëjtën kohë në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës nuk janë plotësuar kushtet për fitimin e pronësisë në paluajtshmëri me parashkrim fitues.
34. Në fund, përmes kërkesës së plotësuar, të dorëzuar më 15 nëntor 2023 propozohet që Gjykata të: (i) deklarojë si të pranueshme kërkesën; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; (iii) të mbajë seancë dëgjimore në përputhje me Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese; dhe (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [C. nr. 3532/2014] e Gjykatës Themelore, Aktgjykimin [AC. nr. 2813/2021] e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [Rev. nr. 235/2023] të Gjykatës Supreme dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[...]

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE PRONËSORE

[Gazeta Zyrtare 6/1980 e ish-RSFJ-së]

Neni 28

“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”.

[...]

Vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për plotësimin e kërkesës

35. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për plotësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të dytë ligjor, z. Taulant Ferizi, më 15 nëntor 2023, dorëzoi kërkesë për plotësimin e kërkesës së tij të parashtruar në Gjykatë më 21 gusht 2023. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se në dorëzimin e kërkesës së tij më 15 nëntor 2023, avokati, z. Taulant Ferizi nuk kishte dorëzuar autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, si rezultat i kërkesës së Gjykatës të 15 nëntorit 2023 autorizimi për përfaqësim u pranua më 27 nëntor 2023.
36. Sa i përket çështjes së ndërrimit të përfaqësuesit ligjor përgjatë zhvillimit të procedurës para Gjykatës, dhe para se kjo e fundit të nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën, kjo çështje, në kuptim të së drejtës së tyre për përfaqësim është në vullnetin e palëve që ata të ndërrojnë përfaqësuesin e tyre ligjor përderisa me kohë njoftojnë Gjykatën dhe dorëzojnë autorizimin përkatës për përfaqësim të tyre. Thënë këtë, Gjykata e respekton këtë vendim të parashtruesit të kërkesës për t'u përfaqësuar edhe nga një përfaqësues tjetër ligjor.
37. Në vijim, në kuadër të shqyrtimit të plotësimin të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, të dorëzuar më 15 nëntor 2023, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën dhe Rregulloren e saj të punës.
38. Paragrafi 4 i nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit përcakton që: *“Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës”.*

39. Në vijim, Gjykata i referohet paragrafëve 3 dhe 4 rregullit 26 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit të përgjigjeve) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, i cili përcakton që:

(3) Nëse një kërkesë nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme, gjyqtari/ja raportues/e, nëpërmjet Sekretarisë, e njofton parashtruesin e kërkesës se kërkesa duhet të plotësohet me informata apo dokumente të specifikuara dhe përcakton saktë se informatat apo dokumentet duhet të dorëzohen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e parashtrimin të kërkesës.

(4) Përveç nëse kërkohet nga Gjykata ose nëse merret leje me shkrim nga Gjykata, pala parashtruese nuk mund të dorëzojë asnjë dokument pas afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimin të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar”.

40. Bazuar në dispozitat e lartcekura të Rregullores të punës së Gjykatës, kjo e fundit thekson se në thelb, rregullat e Rregullores së punës përcaktojnë që parashtruesit e kërkesës nuk mund të dorëzojnë asnjë dokument pas afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimin të kërkesës.
41. Prandaj, Gjykata marrë për bazë faktin, që kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është dorëzuar më 21 gusht 2023, dhe Gjykata ka njoftuar përfaqësuesin e parë të parashtruesit të kërkesës më 7 shtator 2023 për regjistrimin e kërkesës në Gjykatë, konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, për plotësimin e kërkesës, e dorëzuar përmes përfaqësuesit të ri ligjor më 15 nëntor 2023 është dorëzuar jashtë afateve procedurale të përcaktuara me Ligj dhe rregullin 26 të Rregullores së punës (shih në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës KI133/20, me parashtrues *Raiffeisen Bank*, Aktgjykim i 30 marsit 2022, paragrafët 103-105; dhe KI100/23, me parashtrues *Miradije Tusha, Naser Tusha, Artan Tusha, Ajshe Tusha, Hatixhe Tusha, Nadire Tusha dhe Nurhane Vladi-Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 shkurtit 2024, paragrafët 56-57).
42. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se afatet e përcaktuara me Rregulloren e punës, në kuptim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës para Gjykatës, i shërbejnë sigurisë juridike, që nënkupton që palët në procedurë para Gjykatës janë paraprakisht të njoftuara në lidhje me (i) kushtet e dorëzimit të një kërkesë në Gjykatë, (ii) të drejtës së palës kundërshtare për të paraqitur përgjigje dhe (iii) afatit të dorëzimit të informatave dhe parashtrësive tjera brenda afateve të përcaktuara me Ligj dhe Rregullore të punës (shih rastin KI100/23, me parashtrues *Miradije Tusha, Naser Tusha, Artan Tusha, Ajshe Tusha, Hatixhe Tusha, Nadire Tusha dhe Nurhane Vladi-Tusha*, të cituar më lart paragrafi 58).
43. Rrjedhimisht, Gjykata do të vazhdojë me shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të ngritura përmes kërkesës së tij, të dorëzuar më 21 gusht 2023 në Gjykatë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

45. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit, specifikon se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

46. Rregulli 34 (Kriteret e Pranueshmërisë), paragrafi 1, pika (d) e Rregullores së punës specifikon që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.”

47. Andaj, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit përmban gjithsej dy kërkesa. E para, konsiston në (i) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar nga autoriteti publik – vendimin e të cilit e kontestojnë; dhe e dyta, konsiston në (ii) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që dëshirojnë ta kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese. Që të dy këto kriteret të nenit 48 të Ligjit e veçanërisht kriteri i parë i këtij neni reflektohet edhe në rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, ku kërkohet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatë duhet të qartësojë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI73/21, me parashtruese *Minire Krasniqi-Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2021, paragrafi 39; KI91/17, parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31; dhe KI134/23, me parashtruese *Feride Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 32).

48. Në rrethanat e rastit konkret, sa i përket këtyre kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe më tej të specifikuar në Rregullore të punës, Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës ka specifikuar qartë se e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 235/2023] të 3 korrikut 2023, të Gjykatës Supreme, ai nuk e ka përmbushur detyrimin e tij që të *“qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar”* nga autoriteti publik, përkatësisht Gjykata Supreme në rastin konkret. Thënë këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij të dorëzuar në Gjykatë as formalisht por as në substancë nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri themelore, të garantuara me Kushtetutë janë cenuar përmes aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

49. Në kërkesën e tij, të dorëzuar në Gjykatë, më 21 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës vetëm saktëson se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

50. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se kjo dispozitë përfshin detyrimin e autoriteteve publike, përfshirë edhe Gjykatën që *“të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Thënë këtë, kjo dispozitë nuk përfshin ndonjë të drejtë dhe liri themelore specifike, të garantuar me Kushtetutë.

51. Gjkata, në vijim, vëren se parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij të dorëzuar në Gjykatë nuk pajtohet me vendimet e gjykatave të rregullta, dhe se thelbi i pretendimeve të tij ndërlidhet me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga ana e gjykatave të rregullta. Në lidhje me këtë të fundit, në kërkesën e tij, ai specifikon se: “[...] pronësia që kanë fituar paditësit në bazë të parashkrimit fitues në këtë rast nuk ekziston sepse i padituri, respektivisht babai i të paditurit këtë pasuri e ka në posedim dhe shfrytëzim dhe në anë të tij, prandaj nuk janë plotësuar kushtet nga neni 28, paragrafi 4 i LTHMPJ-së dhe i mungon mirëbesimi”.
52. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar nga autoriteti publik ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës.
53. Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 26 dhe 34 (1) (d) të Rregullores së punës, më 29 prill 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- I. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- III. TË KONSTATOJË që ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani